

FJALËT QË DO TË NDIHMOJNË NËSE PUNON NË ITALI

në përkujdesje të Annarita Miglietta (<https://palcom.it/le-parole-che-ti-aiutano>)

Ky broshurë është financuar nga:
Bashkimi Evropian–Next Generation EU,
Misioni 4 Komponenti 2 Investimi 1.1
Projekti P.R.I.N. 202243X77E_001
CUP F53D23006140006

FJALËT QË DO TË NDIHMOJNË NËSE PUNON NË ITALI

PËRMBAJTJA

Praktikë (apprendistato)	4
Çeku unik (ADISA-assegno unico)	5
Sigurimi shëndetësor	6
Përfitime (benefit)	7
Kupona për ushqim	8
Fleta e pagës	9
Leje për pushime (congedo)	10
Leje martesë	11
Leje prindërore	12
Leje për lindje	13
Leje për atësi	14
Kontrata kolektive kombëtare e punës (CCNL)	15
Kontratë pune me kohë të caktuar	16
Kontratë pune me kohë të pacaktuar	17
Kontributet e sigurimeve shoqërore	18
Dorëheqja	19
Të drejtat	20
Vendbanimi	21
Detyrimet	22
Pushimet	23
Përfitimi muajor i papunësisë (NASPI)	24
Aksident në punë	25
Istituti i sigurimeve Shtetërore (INPS)	26
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS (INAIL)	27
Punë ditore në ditë festash	28
Punë gjatë natës	29
Punë shtesë	30
Pushimi nga puna (licenziamento)	31
Ngacmimet në punë-mubingu (mobbing)	32
Pensioni	33
Periudha e provës	34



Bonus vjetor (quatordicesima)	35
Vëndbanimi	36
Rritje page sipas vjetërsisë në punë(scatti di anzianità)	37
E drejta e grevës	38
Sindikatat	39
Pagesa	40
Paga në bruto	41
Paga në neto	42
Udhëtim për çëshje pune (trasferta)	43
Përfundim marrëdhënie pune (TFR)	44
Zbritjet në pagë	45
Pagesë trembëdhjetëshe (tredicesima)	46
Ushqim dhe akomodim (vitto e alloggio)	47



PRAKTIKË PROFESIONALE (APPRENDISTATO) (4)

Është një lloj pune që të lejon të mësosh një zanat.

Mirë se erdhe

SOT FILLON PERIUDHA E PRAKTIKËS.

AI DO TË TË NDIHMOJ TË MËSOSH

A do të kem kontratë dhe pagesë?

Po, sigurisht. Ndërkoh që punon, merr pagë dhe mëson gjëra të reja.

ÇEKU UNIK-(ADISA) (5)

Është një ndihmë me para për ata që kanë fëmijë. E jep Shteti.

Mirë se erdhe, kjo është çeku unik për familjen tënde

FALEMINDERIT

SIGURIMI SHËNDETËSOR (6)

Është një ndihmë për të paguar doktorin ose spitalin kur sëmuresh.

Sa kushton?

Mbulohet nga sigurimi shëndetësor

KARTË SHËNDETËSORE

PËRFITIME (BENEFIT) (7)

Janë përparësi për punonjësit. Shefi yt ose shefja jote mund të të japin diçka më tepër përveç pagës.

Për shembull: kupona për ushqim, zbritje ose ndihma për ty dhe familjen tënde.

ÇFARË JANË?

Janë benefitë.

Këto janë zbritje për t'u futur në palestër

KUPON PALESTRE

KUPONA PËR USHQIM (BUONI PASTO) (8)

Janë bileta, tiketa ose një kartë që shefi yt ose shefja jote të japin për të blerë ushqim në supermarket, bare, restorante ose mensa.



FALEMINDERIT

këto janë kupona ushqimi që mund t'i përdorësh për të blerë ushqim
Faleminderit!

Mund të paguaj me këto tiketa?

Po, këtu mund të paguash me këto

FLETA E PAGËS (BUSTA PAGA) (9)

Është një dokument që shefi yt ose shefja jote të japin çdo muaj. Në letër shkruhet sa para merr për punën. Duhet ta ruash sepse është e rëndësishme.

Kjo është fletpagesa së këtij muaji

ÇFARË JANË KËTO NUMRA?

MUND TË SHOHESH SA PARA DO KËSH KËTË MUJ DHE SA TAKSA KE PAGUAR

Shumë faleminderit

LEJE (CONGEDO) (10)

Periudhë në të cilën nuk punon dhe ke të drejtë të mos shfaqesh në punë.

nesër duhet të rinovoj lejen e qëndrimit (permesso di soggiorno).

mirë! nesër mund të mungosh nga puna. Kërko leje

LEJE MARTESORE (CONGEDO MATRIMONIALE) (11)

Është periudha prej disa ditësh pushimi që mund ta marrësh nëse martohesh. Gjatë kësaj periudhe merr pagesë.

Mund të qëndroj disa ditë në shtëpi falë lejes martesore

LEJE PRINDËRORE (CONGEDO PARENTALE) (12)

Është periudha kur bëheni nënë. Janë ditët mbas lindjes së foshnjës. Gjatë kësaj periudhe mund të qëndrosh në shtëpi për të qenë me foshnjën tuaj.

Sot askush nuk mund të rrijë me fëmijët e mi

MUND TË QËNDROSH TI ME ATO DHE KËRKON LEJEN PRINDËRORE

LEJE PËR LINDJE (CONGEDO PER MATERNITÀ) (13)

Është periudha kur nuk shkon në punë nëse do të bëhesh nënë. Janë ditët para dhe pas lindjes së vajzës ose djalit. Gjatë kësaj periudhe do të marrësh pagën.

Nuk do të shkoj në punë për pak kohë pas lindjes së vajzës sime

LEJE PËR ATËSI (CONGEDO PER PATERNITÀ) (14)

Është periudha kur mund të qëndrosh në shtëpi nëse bëhesh baba.

Merr vetëm një pjesë të pagës sënde

Sapo lindi vajza ime, do të rri disa ditë me të

KONTRATA KOLEKTIVE KOMBËTARE E PUNËS (CCNL) (15)

Është një dokument me rregullat e punës. Tregon çfarë mund të bësh dhe çfarë duhet të bësh. Shpjegon sasinë e lekëve që duhet të marrësh dhe sa orë duhet të punosh. Tregon sa ditë pushim ke dhe çfarë ndodh nëse sëmuresh. Shpjegon ç'ndodh në se keni fëmijë.

Si mund ta di sa orë duhet të punoj dhe sa ditë pushim kam?

Mund ta kontrollosh në kontratën kolektive kombëtare të punës (CCNL), aty gjenden të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tua.

KONTRATË PUNE ME KOHË TË CAKTUAR (16)

Është një marrëveshje pune mes teje dhe shefit ose shefes tënde. Ka një datë fillimi dhe një datë mbarimi pune. Është një dokument i rëndësishëm që duhet ta lexosh dhe ruash.

Çfarë do të thotë?

kjo është kontrata jote për kohë të caktuar,

do të thotë se puna jote ka një datë fillimi dhe një datë mbarimi.

KONTRATË PUNE ME KOHA TË PACAKTUAR (17)

Është një marrëveshje pune mes teje dhe shefit ose shefes tënde. Ka datë fillimi dhe nuk ka datë mbarimi (afatgjat). Mund të punosh sa të duash ose deri sa shefi yt të të shkarëjë. Është dokument i rëndësishëm që duhet të lexosh dhe ruash.

Kam kontratë pune me kohë të pacaktuar!

Urime, do të thotë që puna jote ka datë fillimi por nuk ka datë mbarimi.

KONTRIBUTE (18)

Janë lekët që shefi yt ose shefja jote i jep shtetit. I shërbejnë për të ndihmuar në rast sëmundjeje, në raste kur mund të humbasësh punën ose kur të jesh i moshuar.

Çfarë janë kontributet?

janë para që çdo muaj shefi ynë i jep shtetit për të na ndihmuar kur të bëhemi të moshuar dhe të mos punojmë më.

DORËHEQJA NGA PUNA (DIMISSIONI) (19)

Ti vendos të largohesh nga puna dhe ia komunikon shefit ose shefes tënde.

Do lërë punën sepse po largohem nga Roma, po zhvendosem në Milano.

Pranoj dorëheqjen tënde. Fat të mbarë.

TÈ DREJTAT (20)

Janë rregulla që të mbrojnë ty, për t'u ndihmuar të jetosh mirë.

Çfarë janë të drejtat?

Janë rregulla që shërbejnë për të mbrojtur njerëzit nga padrejtësitë. Për shembull, ke të drejtë për pushim nga puna.

ADRESIMI (21)

Është shtëpia ku jeton për një periudhë. Është në qytetin ku punon dhe merr komunikimet e rëndësishme. Është e ndryshme nga vëndbanimi.

Shembull: Nëse punon në Milano dhe jeton në Romë. Adresimi yt është në Milano. Vëndbanimi jote është në Romë.

Më duhet të zhvendosem për disa muaj në Milano.

Tani kam adresimin këtu ku punoj.

DETYRIMET (22)

Janë gjëra që duhet t'i bësh për të jetuar mirë me të tjerët dhe për të respektuar rregullat (respekto ligjin, paguaj taksat, dërgo fëmijët në shkollë).

Si qytetarë kemi detyrime, domethënë rregulla që duhet t'i respektojmë, si për shembull të shkojmë në shkollë ose të paguajmë taksat.

PUSHIMET (FERIE) (23)

Janë ditë në të cilat nuk punohet. Mund të pushosh ose të bësh një udhëtim.

Edhe nëse nuk punon, shefi yt ose shefja jote të japin pagën.

kemi dhjetë ditë pushim në gusht

Të uroj pushime të këndëshme

gjithashu edhe për ty

PËRFITIM MUJOR I PAPUNËSISË (NASPI) (24)

Është një ndihmë me para që të jep shteti kur humb punën dhe kërkon një punë të re.

Më kanë pushuar nga puna

deri sa të gjesh një punë të re. Është një ndihmë me para që të jep shteti

AKSIDENT NË PUNË (25)

Është dëmi, aksident që mund të ndodhë gjatë punës.

çfarë ndodhi?

U lëndova ndërsa isha në punë

INSTITUTI KOMBËTAR I SIGURIMEVE SHOQËRORE (ISSH-INPS) (26)

Është zyra që jep pensionin. Gjithashtu jep para nëse humb punën, ke fëmijë ose je i sëmurë.

Çfarë është kjo zyrë?

është një zyrë që do t'i japë paratë kur të dalësh në pension, ose nëse humb punën

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS (ISP-INAIL) (27)

Është një zyrë që të ndihmon nëse lëndohesh në punë. Të ndihmon edhe nëse sëmuresh për shkak të punës.

mirëmëngjes, çfarë ndodhi?

Pata një aksident në vendin e punës dhe u lëndova

PUNË FESTIVE (28)

Është puna që bën gjatë festave, si në Krishtlindje ose për Pashkë.

turni im i punës do të jetë gjatë festave

Këtë vit do të punosh në ditën e Krishtlindjes

PUNË NATE (29)

Është puna që bën natën.

Përse je në punë në këtë orë?

Sot kam turnin e natës

PUNË SHITESË (STRAORDINARIO) (30)

Është puna që bën më shumë pas orarit normal.

Sot do të qëndroj në punë dy orë më shumë. Do të llogaritet si punë shtesë

Mirë, do të qëndroj deri në orën 20:00 në vend të 18:00

PUSHIMI NGA PUNA/SHAUPIM (LICENZIAMENTO) (31)

Shefi yt ose shefja jote të largojnë nga puna dhe ti nuk mund të punosh më për ta.

Duhet të të shpjegojnë arsyen.

Fatkeqësisht nuk mund të punosh më për ne sepse kjo kompani do mbyllet në fund të muajit

PAÇ FAT TË MBARË

FALENDERIT

MOBINGU-MOBING (32)

Shefi yt, shefja jote ose kolegët e tu të trajtojnë keq kur punon. Janë të këqij me ty, bërtasin, të ofendojnë.

kolegët e mi më trajtojnë gjithnjë keq dhe më ofendojnë



PENSIONI (33)

Janë paratë që merr çdo muaj kur je i moshuar dhe nuk punon më.

TANI QË JAM I VJETËR DHE NUK PUNOJ MË, MARR ÇDO MUJ PENSIONIN TIM

PERIUDHA PROVE (34)

Është fillimi i punës. Gjatë këtyre ditëve ti dhe shefi ose shefja jote shihni nëse puna të përshtatet dhe nëse ata janë të kënaqur me ty. Mund të vendosni nëse do të firmosni apo jo kontratën dhe nëse do të punoni së bashku.

Sot fillon periudha e provës?

Po, gjatë kësaj periudhe mund të shohim nëse punon mirë dhe nëse na pëlqen të punojmë së bashku.

BONUS MUJOR (QUATTORDICESIMA) (35)

Janë para shtesë që shefi ose shefja jote mund t'i japë një herë në vit, zakonisht në korrik ose gusht, për t'ju ndihmuar me shpenzimet.

ka disa para më tepër këtë muaj

Po, një herë në vit, verës, shefi na jep bonus mujor.

ADRESIMI (36)

Është shtëpia ku kalon më shumë kohë: fle, ha. Duhet të regjistrohesh në Bashki. Të nevojitet për kartën e njoftimit, mjekun, shkollën e fëmijëve të tu.

Shembull: nëse punon në Milano dhe jeton në Romë. Adresimi yt është në Milano. Vëndbanimi jote në Romë.

Këtu është vendi ku jetoj me gjithë familjen time

mirëmëngjes, jetoj në këtë qytet me gjithë familjen time

Ok! Mund të regjistrojmë vëndbanimin tuaj

RRITJE SIPAS VJETËRSISË (SCATTI DI ANZIANITÀ) (37)

Janë një shumë parash që merr pas disa vitesh (dy ose tre) pune në të njëjtin vend.

Punon me ne prej disa vjetësh, do të marrësh një rritje vjetërsie

FALEMINDERIT!

GREVA (SCIOPERO) (38)

Punëtorët dhe punëtoret ndalojnë dhe nuk punojnë për të protestuar ose për t'u ankuar për diçka. E bëjnë për të kërkuar paga më të larta ose për të punuar më mirë (që të kenë më shumë të drejta).

Protestojmë për të punuar më mirë dhe për të pasur më shumë të drejta

SINDIKATA (39)

Janë antar që ndihmojnë punëtorët dhe punëtoret për të mbrojtur të drejtat e tyre. Të ndihmon nëse ke probleme në punë me shefin tënd.



Kam disa probleme në punë me shefin tim
Mund të kërkoksh ndihmë nga sindikata. Të ndihmojnë të mbrosh të drejtat e tua.

PAGA (STIPENDIO) (40)

Është pagesa: janë paratë që shefi yt ose shefja jote të japin çdo muaj për punën që bën.
çdo muaj marr para për punën që kam bërë

PAGESA BRUTO (STIPENDIO LORDO) (41)

Janë paratë që shefi yt ose shefja jote të premtojnë të japin për punën tënde, para se të hiqen taksat, zbritjet.

për këtë punë do të paguaj çdo muaj 1000 € bruto
janë paratë nga të cilat do të hiqen taksat që duhet të paguash!
Mirë

PAGA NETO (STIPENDIO NETTO) (42)

Janë paratë që në fakt i merr. Shembull: nëse paga jote bruto është 1.000 euro, me zbritjet mund të marrësh 800 euro.

shefi më tha se do më paguante 1.000 €, pse mora më pak para?
Kjo që more është paga jote neto, pra paratë që merr pas pagesës së taksave

TRASFERIM PER PUNE (TRASFERITA) (43)

Është një udhëtim pune. Shefi yt ose shefja jote të dërgon të punosh në një vend tjetër nga vendi ku punon zakonisht. Për shembull, punon në Lecce dhe shefi të dërgon për tre ditë të punosh në Bari.

Duhet të nisësh për një transferim. Nga sot deri të hënën tjetër do të punosh në Bari.
mirë

Rrugë të mbarë (o udhëtim të mbarë)

PËRFUNDIM MARRËDHËNIE PUNE (TFR–Trattamento di Fine Rapporto) (44)

Janë paratë që shefi yt ose shefja jote të japin kur përfundon punë me ta (je shkarkuar ose largohesh vetësisht) ose kur shkosh në pension. Është një kursim i vogël për punën që ke bërë.

Punon me ne. Sot është dita jote e fundit e punës dhe kjo është TFR yt (shpërblim)
Faleminderit!

ZBRITJET TATIMORE (TRATTENUTE SULLO STIPENDIO) (45)

Janë paratë që hiqen çdo muaj nga paga jote.

Ka një gabim, mora më pak rrogë!

Nuk është një gabim. Paratë që nuk sheh përdoren për të paguar tatimet, domethënë taksat për shtetin



PAGESA E TREMBDHJETË (TREDICESIMA) (46)

Janë para shtesë që merr në dhjetor.

Edhe ti ke marrë para më shumë?

Po, është rroga trembdhjetëshe. Para që shefi na jep çdo vit në dhjetor

USHQIM DHE STREHIM (VITTO E ALLOGGIO) (47)

Shefi yt ose shefja jote të japin ushqim dhe një vend ku të qëndrosh, përveç pagës.

Për këtë punë përveç pagës do të të japim edhe një dhomë ku të qëndosh dhe mund të hash në mensë Faleminderit!